

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me sekretaren juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.Ll. dhe K.Ll., që të dy nga P., rr. “...” pn, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.2 lidhur nën 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1737/13 të dt.27.09.2013, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur më dt.11.05.2016, në praninë e prokurorit të shtetit Bashkim Zeqaj dhe të akuzuarve M. dhe K.Ll., pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me dt.17.05.2016 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

- 1. M.LL.**, nga i ati Sh. dhe nëna H., e vajzërisë R., i lindur *data e lindjes...*, në fshatin H., tani me vendbanim në P., rr. “...” pn, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së dobët ekonomiko-sociale, i martuar, baba i 3 fëmijëve, nuk ka të dhëna që ka qenë i gjykuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. K.LL.**, nga i ati Q. dhe nëna S., e vajzërisë P., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin H., tani me vendbanim në P., rr. “...” pn, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike - jeton nga ndihma sociale e një djali i cili është me aftësi të kufizuara, i martuar, baba i 5 fëmijëve, nuk ka të dhëna që ka qenë i gjykuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## J A N Ë F A J T O R Ë

### Sepse:

Më datën 25.09.2012, rreth orës 13:30, të pandehurit në bashkëveprim kanë shkuar në pyllin publik në vendin e quajtur “T.”, në regionin ekonomiko - pyjor Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pyltëtarisë dhe Zhvillimit Rural - Sektori i Pyltëtarisë, të pandehurit me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, janë zënë në flagrancë nga rojet e pyllit duke prerë 6 copë trugje të llojit ahu me sharrë motorike, të gjata 21m, diametër 27-37cm, me vëllim të përgjithshëm 5.28 m<sup>3</sup>, me

ç'rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Sektori i Pylltarisë, i kanë shkaktuar dëm material në vlerë rreth 712.80 €,-

-me këtë në bashkëveprim kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 285 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 6, 11, 34, 35, 41, 42, 43, 44, 64 dhe nenit 285 par.2 dhe par.1 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, i

## **G J Y K O N**

**I.** Të akuzuarit **M.(Sh.) Ll.** dhe **K.(Q.) Ll.**, me **dënim me kusht**, ashtu që iu shqipton **secilit veç e veç dënim me burg** në kohëzgjatje **prej gjashtë (6) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit **brenda afatit prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë vepër të re penale.

**II.** Detyrohen të akuzuarit e lartcekur që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajnë **secili veç e veç shumën prej 25.00€ (njëzetepesë euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**III.** E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzaën PP.II.nr.1737/13 të dt.27.09.2013, kundër të akuzuarve Sh.Ll., S.Ll., M.Ll. dhe K.Ll., që të gjithë nga P., Lagjja e "...", për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin e datës 11.05.2016, bëri veçimin e procedurës penale kundër të akuzuarve Sh.L. dhe S.Ll., për shkak se të njëjtit gjenden në botën e jashtme dhe me qëllim të efikasitetit dhe pa zvarritje të procedurës penale për të akuzuarit tjerë M.Ll. dhe K.Ll., ashtu që lënda ndaj të akuzuarve Sh.Ll. dhe S.Ll. do të regjistrohet dhe do të merr numër të ri.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.05.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Bashkim Zeqaj dhe të akuzuarve M.Ll. dhe K.Ll.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë së të akuzuarve, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme, pa presion dhe ndikim, në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së, dhe i propozoj gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve.

I akuzuari M.Ll. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, arsyeja pse kam shkuar në mal është për t'i ndihmuar axhës tim K. për ti marrë drutë për nevoja të familjes së tij, pasi që e ka një djalë me aftësi të kufizuara, drutë nuk i kemi marrë, kërkoj nga gjykata që të më shqipton një dënim sa më të butë, pasi që është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin.

I akuzuari K.Ll. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, arsyeja është se atë ditë kam shkuar për të siguruar dru për ngrohje për familje, pasi jam pa të ardhura personale dhe kam një djalë i cili është me aftësi të kufizuara dhe jetoj vetëm nga ndihma sociale që e marr për të, ditën kritike drutë nuk i kemi marrë ngase jemi zënë nga roja e pyllit në vendin e ngjarjes dhe nga Policia e Kosovës, kërkoj nga gjykata që të më shqipton një dënim sa më të butë, pasi që është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, bëri rikualifikimin e veprës penale konform nenit 3 par.2 të KPRK-së, nga vepra penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pasi që në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në fuqi ky ligj dhe sipas tij për këtë veprë penale është paraparë dënimi alternativ - me gjobë ose me burgim, ndërsa me ligjin e ri i është paraparë dënimi kumulativ – me gjobë dhe me burgim, ashtu që gjykata bëri rikualifikimin e veprës penale si më lart, pasi që vlerësoi se ky ligj është më i favorshëm për palën e akuzuar.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve M.Ll. dhe K.Ll., përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në bashkëveprim vjedhje pylli nga neni 285 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës dhe të njëjtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 64 të KPK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, ishin të sinqertë, për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën jetojnë, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimit të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil u morë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata nuk pati ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetoj saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.890/2013, më dt.17.05.2016**

**Sekretare juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.